



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

30.12.2025

MARRE NË DORËZIM-PRIMEN-NO-RECEIVED			
Numri Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	78182	3

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

HYRJE

Ky Plan i Punës përcakton drejtimet strategjike, objektivat dhe prioritetet e Komunës së Suharekës për vitin 2026, nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës, z. Bali Muharremaj, dhe në bashkëpunim të plotë me drejtoritë komunale dhe sektorët përkatës. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike relevante, me qëllim të planifikimit, koordinimit dhe zbatimit të projekteve dhe aktiviteteve komunale në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të komunës.

Plani i Punës për vitin 2026 bazohet në analizën e gjendjes aktuale, rezultatet e arritura në periudhat paraprake, si dhe në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës së Suharekës. Ai përfshin projekte dhe masa konkrete në fusha prioritare, përfshirë investimet kapitale, zhvillimin ekonomik lokal, infrastrukturën rrugore dhe urbane, shërbimet publike, arsimin, kulturën, sportin, mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien sociale.

Komuna e Suharekës mbetet e përkushtuar ndaj zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe menaxhim të përgjegjshëm të fondeve publike, veçanërisht në planifikimin dhe realizimin e projekteve komunale. Të gjitha projektet e planifikuara për vitin 2026 do të realizohen në përputhje me procedurat ligjore, standardet profesionale dhe afatet e përcaktuara.

Ky Plan i Punës paraqet një kornizë të qartë orientuese për veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorive komunale dhe sektorëve përkatës, duke përcaktuar përgjegjësitë institucionale, objektivat e matshme dhe aktivitetet konkrete për secilën fushë. Zbatimi i këtij plani synon të sigurojë koordinim efikas ndërmjet strukturave komunale dhe realizim të suksesshëm të projekteve në interes të qytetarëve.

Plani i Punës për vitin 2026 shërben gjithashtu si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e performancës institucionale, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të Komunës së Suharekës për zhvillim të qëndrueshëm, shërbime cilësore dhe përmirësim të vazhdueshëm të jetës së qytetarëve.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENC

Sektori i Shërbimeve publike

Gjatë vitit 2026 si zakonisht në Sektorin e Shërbime Publike do të bëhen punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme, me të cilat jemi të angazhuar në këtë drejtori janë:

- Pranimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve, për rrugë, kanalizime, ujësjellës, ndriqime publike, si dhe shumë kërkesa tjera që i përkasin Drejtorisë sonë, po ashtu edhe shqyrtimi i tyre në teren me kërkesën e Drejtorit.

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale mallrave dhe shërbimeve, si dhe kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat e shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturinave.

- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

- Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, Eko Therandën etj, për nevojat e Komunës dhe të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.

- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e komunës.

- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre, po ashtu edhe përgaditja e kërkesave KEDS-it për vendosjen e orë matëseve të rrymës për objektet e ndërtuara nga Komuna, si dhe ndriqimeve publike.

- Përgaditja e kërkesave për Hidroregjionin Jugor njësisë Suharekë, për vendosjen e orë matëse të ujit për objekte të ndryshme të ndërtuara nga Komuna.

- Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë), por gjithmonë të koordinuara me Drejtorinë dhe në bashkëpunim si gjithmonë.

- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,

- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.

- Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre .

- Takime të shpeshta me KFOR-in OSBE për nevojat e ndryshme të Komunës.

- Përgaditja dhe planifikimi i buxhetit për çdo vit, për shpenzime Komunale dhe mallra dhe shërbime, si dhe për kërkesa të ndryshme brenda Drejtorisë etj.

- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit dhe Drejtorinë e Arsimit (DKA) e tjera) ,pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësisë Suharekë “ Eko-regjionin “ njësisë Suharekë, KEDS-in, PTK-në etj.

Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë;

Mirëmbajtja e Intrantit të Drejtorisë rreth kërkesave

Organizimin e regjistrimit të inventarit dhe mjeteve themelore

-Menaxhimi i Mbeturinave

1) Mirëmbajtja e rrugëve lokale nga bora

2) Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale në Komunë

Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, duke përfshirë grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave

- Organizimi në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale dhe në vendbanime, pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit;
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, hapësirave gjelbëruese, parqeve publike dhe varrezave të Dëshmorëve në territorin e Komunës.
- Bashkëpunimi me kompaninë që ofron shërbime rreth grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.
- Organizimi dhe koordinimi i punëve me kompanitë që ofrojnë shërbime për qytetarët;
- Kontroll dhe mbikëqyrjen rreth realizimit të kontratave të ndërmarrjeve për punë të kontraktuar në shërbim;
- Pranimin dhe dorëzimin e raporteve dhe faturave të dorëzuar nga operatorët;
- Organizimin e regjistrimit të inventarit dhe mjeteve themelore;
- Hapjen dhe vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të zyrës së prokurimit;
- Kryerjen e pagesave në FreeBalanc, Alternativ e zyrtarit të Shpenzimeve;
- Dalje në teren rreth shqyrtimit të Ankesave dhe kërkesave nga ana e Qytetarëve;
- Mirëmbajtja e Intrantit të Drejtorisë rreth kërkesave;
- Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë;

Inspektori i preventives së Zjarrit 2026

Lënda: Plani i punës për periudhën Janar- Dhjetor 2026

Viti 2026 do të jetë viti ku do të inspektohen një numër objektsh që janë të rëndësishme në aspektin e mbrojtjes nga zjarri, duke pasur parasysh gjendjen në teren, inspektimet e vazhdueshme të objekteve, rrezikshmërinë dhe numrin në rritje të objekteve të cilat janë duke u ndërtuar.

Prania jonë në teren, bisedat me qytetarët, me pronarë të objekteve si dhe bashkëpunimi me institucionet AME, Komunë, hetuesit policor me rastin e zjarreve, e bën punën tonë mjaft të rëndësishme në parandalimin e zjarreve, të mirave materiale dhe shpëtimin e jetës së njerëzve. Në këtë plan vjetor të punës, janë të evidentuara disa prej objekteve të cilat do të inspektohen, duke përfshirë edhe ato të mbetura nga viti i kaluar, dhe punë tjera të lemisë së parandalimit të zjarrit

MUAJI J A N A R

1. HANDIKOS Suharekë insp.fillestar.....
2. Objekti i sh.f. “ 28 Nëntori “ Dobërdelan insp.i rregullt.....
3. Objekti i AMF në Dobërdelan insp.fillestar.....
4. Inspektime të marketeve në Suharekë.....
5. Inspektime kontrolluese.....

MUAJI SHKURT

1. Inspektim i lokaleve dhe kafiterive të ndryshme.....
2. VOCI COMER Shirokë insp.i rregull i objektit.....
3. SHELL Shirokë insp. i rregullt.....
4. Supermarketi “ BENI “ Bukosh insp.i rregullt.....
5. Inspektime kontrolluese të objekteve më heret të inspektuara.....

MUAJI MARS

1. Shtëpia e kultures “ Ukë Bytyqi “ në Suharekë insp.i rregullt.....
2. Qendra tregtare “ KASTRATI” Shirokë insp. Fillestar.....
3. Pruarje të Aktvendimeve.....
4. Sallone të mobiljeve Suharekë insp.te rregullta.....
5. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....

MUAJI PRILL

1. Objekti depo e materialeve ndërtimore Shirokë.....
2. TEB Banka Suharekë insp i rregullt.....
3. Insp.i dyqaneve të ndryshme në teren.....
4. Hotel restorant “ HAREA “ Reqan inspektim fillestar.....

MUAJI MAJ

1. Objekti i sh.fill.” DRITA “ Gelancë insp.i rregullt.....
2. BIH PETROL Duhël insp.i rregullt.....
3. Teb Banka Suharekë insp. i rregullt.....
4. Pruarja e Aktvendimeve.....
5. Dalje në vendngjarje.....
6. Inspektime kontrolluese të objekteve.....

MUAJI QERSHOR

1. Fabrika për prodhimin e produkteve medicinale në Shirokë insp. i rregullt....
2. Shtabi Komunal i korrje shirjes aktivitete të korrje shirjes,dhe parandalimit te zjarrit gjatë sezonit, inspektimi i kombajnave mbi gjendjen teknike, dhe posedimin e mjeteve per fikjen e zjarrit
3. Pranim teknik të objekteve.....
4. Dalje në teren vëzhgim mbi gjendjen në teren dhe në zonat potenciale të shpërthimit të zjarreve duke u bazuar në përviojat e viteve të kaluara.....
5. Raport gjashtëmujor.....

MUAJI KORRIK

1. Inspektim i autokombajnave dhe mjeteve tjera në teren të angazhuara për korrje shirje.....
2. Inspektime kontrolluese.....
3. Dalje në teren, biseda me banorë të fshatrave rreth zjarreve pyjore dhe dëmeve që shkaktohen nga paraqitja e zjarreve.....
4. Shpërndarje e APEL-it n-it nëpër fshatra të komunës mbi senzibilizimin e popullatës për kujdesin e vazhdueshëm në parandalimin e zjarreve.....
5. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....
6. Raporte nga tereni për sezonin e korrje shirjes.....

MUAJI GUSHT Në pushim vjetor

MUAJI SHTATOR

1. Fabrika e mobiljeve “ Graniti” në Gjinoc insp.i rregullt.....
2. Kosova Hollding Shirokë insp.i rregullt.....
3. Inspektim i lokaleve të ndryshme.....
4. Inspektime kontrolluese të objekteve.....
5. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....

MUAJI TETOR

1. Objekti i sh.m.t. Skender Luarasi në Suharekë insp.i rregullt.....
2. Fabrika e mobiljeve Shirokë,zona industriale insp.i rregullt.....
4. Inspektimi i Lokaleve dhe dhe picerive të ndryshme.....
4. Objekti tregtar “ Blear “ Shirokë inspektim fillestar.....
5. Depo të materialeve ndërtimore insp.i rregullt.....

MUAJI NËNTOR

1. Ombulanca private OLIVE në Suharekë insp.fillestar.....
2. BALKAN BELT Suharekë insp.i rregullt.....
3. Pruarje te Aktvendimeve.....

4. Inspektime kontrolluese të objekteve..... 5.

Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....

MUAJI DHJETOR

1.Pompa e benzinës Lab Oil Dubravë insp.i rregullt.....

2 Depo ushqimore për shpërndarje në Shirokë insp.i rregullt.....

3. Inspektime të dyqaneve ku mbahen dhe tregëtohen mjete piroteknike.....

4.Raporti i punës për vitin 2025.....

5. Përpilimi i planit vjetor të punës për vitin 2026.....

Draft Lista e investimeve kapitale që do të ekzekutohen gjatë vitit 2026:

	Emri i Projektit	Plani 10- BKK	Plani 21-THV	TOTAL: 2026
Vendbanimet	TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2026-2028	#REF!	#REF!	#REF!
	Shërbimet Publike, Mjedis, dhe Emergjencë	2,447,260.00	862,591.00	3,309,851.00
Bllacë	Ndertimi i rrugëve lokale "Shkodra", "Sahit Tixhja", "Rizah Bllaca", "Kukësi" "Kastrioti", "Shefket Zekolli", "Xhemajl Zekolli", "Bislim Zekolli"-degëzim, "UÇK"-degëzim, "Vlora"-degëzim, dhe Sherif Hoxha" në Bllacë .	60,000.00	20,000.00	80,000.00
Breshancë	Ndertimi i rrugës "Te Varrezat-Parajsa" -vazhdim në Breshancë .	10,000.00		10,000.00
Budakove	Ndërtimi i rrugëve lokale "Furra e UÇK-së", "Ali Buqa"e "Sherif Buqa" në Budakovë .	35,000.00	15,000.00	50,000.00
Buzhale	Ndërtimi i rrugës lokale "Flanga" faza e parë në Buzhalë .	15,251.00	6,591.00	21,842.00
Bukoshe	Ndërtimi i rrugëve lokale "Qamil Kadolli " në Bukosh .	25,000.00	15,000.00	40,000.00
Delloç	Ndërtimi i rrugës lokale "Elez Isufi " në Delloç .	10,000.00	-	10,000.00
Doberdelan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Jemin Cikaqi", dhe "Shefket Mehmeti" - në Doberdelan .	20,000.00	10,000.00	30,000.00
Dubravë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Rruga e UÇK-së " dhe rrugës "Dubravë-Savrovë" në Dubravë .	20,000.00	5,000.00	25,000.00
Duhel	Ndërtimi i rrugëve lokale "Halim Lugi", "Halim Bujari", "Ilir Perteshi" dhe rruga "Xhamia" në Duhel	20,000.00	20,000.00	40,000.00
Dvoran	Ndërtimi i rrugës lokale "Diga"	10,000.00	-	10,000.00
Gelance	Ndërtimi i rrugëve lokale "Rruga Kryesore", "Halim Trolli", "Osumi" -vazhdim në Gelanc .	50,000.00	40,000.00	90,000.00
Gjinoc	Ndërtimi i rrugëve lokale "Joni", "TMK-së ", "Mbërti Agron"-segmenti 1 dhe 2 "Lidhja e Pejës"-segment, "Theranda "-segment, "Rrrethoja e Vorrezave"-vorrezat e Sadris në Gjinoc .	50,000.00	20,000.00	70,000.00
Grejkoc	Ndërtimi i rrugëve lokale "17 Shkurti", "Qerim Bajrami", "Qail Asllan Kicaj", "Qamil Limani "	40,000.00	30,000.00	70,000.00
Grejqevc	"Ndërtimi i rrugës lokale "2 Martirët "vazhdim	30,000.00	20,000.00	50,000.00
Javor	Ndërtimi i rrugës lokale "Ismet Jashari" në Javor	20,000.00	-	20,000.00

Kasterc	Ndërtimi i rrugëve lokale "Hasan Muslia", "Bajram R Hajdari"	10,000.00	-	10,000.00
Krushice e eperme	Ndërtimi i Trotuarit	10,000.00	-	10,000.00
Krushice e poshtme	Ndërtimi i rrugës te varrezat	10,000.00	-	10,000.00
Leshan	Ndërtimi i rrugëve "Ismet Kodra"degëzim"Bashkim Kabashi" degëzim,Shaban Gashi" -segment në Leshan .	25,000.00	15,000.00	40,000.00
Luzhnice	Ndërtimi i rrugës "Vesel Pagarusha"	15,000.00	-	15,000.00
Maqiteve	Ndërtimi i rrugëve lokale "Arrishta", "Ramë Ahmeti", "Haradini"	30,000.00	20,000.00	50,000.00
Mohlan	Rregullimi i infrastruktures rrugore	10,000.00	-	10,000.00
Mushtishti	Ndërtimi i rrugës lokale"Rugova"dy degëzime, "Hazir Behluli", "Jakup Jakupi"- degëzim,"Verishtat"-degëzim,"dhe Qehaja", "Lugjet e Mretërve", "Bajram Kurti"-degëzim.	60,000.00	20,000.00	80,000.00
Neperbisht	Ndërtimi i rrugëve lokale "Rifat Qerimi", "Haxhi Isa" dhe "Requaku"në Neperbisht .	25,000.00	-	25,000.00
Nishor	Ndërtimi i rrugëve lokale "Adem Syla", "Rasim Emrushit"	30,000.00	20,000.00	50,000.00
Papaz	Ndërtimi i rrugëve "Pentagoni",Luftëtari i Lirisë	10,000.00	-	10,000.00
Peqan	Ndërtimi i rrugëve lokale"Frank Bardhi", "Jashar Shasivar Bytyqi", "Enver Hadri", "Salih Budka .	20,000.00	20,000.00	40,000.00
Popolan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Smajl Ferati"	10,000.00		10,000.00
Qadrak	Ndërtimi i rrugës lokale "Mehmet Tafolli",vazhdim	30,000.00	20,000.00	50,000.00
Reqan	Ndërtimi i rrugës lokale "Rozafa"vazhdim	50,000.00		50,000.00
Reshtan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Skenderbeu", "Mehmet Bytyqi", "Mrizi i Zanave"	20,000.00		20,000.00
Komunë	Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike në fshatra ,Savrovë ,Doberdelan,Bukosh,Sopijë dhe Komunë .	204,000.00	96,000.00	300,000.00
Komunë	Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve Buzhalë,Bllacë,Dubravë,dhe ne Suharekë	170,000.00	50,000.00	220,000.00
Komunë	Ndërtimi dhe rikonstruimi i lumenjeve "Toplluha" ,Leshan ,Mushtisht,Sopijë,dhe Peqan.	223,009.00	50,000.00	273,009.00
Komunë	Ndërtimi dhe trotuareve dhe parkingjeve ne Suhareke	90,000.00	30,000.00	120,000.00
Komunë	Ndërtimi i zonave te gjelbruara rekroative ne Nishor,Sallagrazhdë dhe në Suhareke	20,000.00	30,000.00	50,000.00
Komunë	Ndërtimi i urave ne Reqan,Reshtan dhe Bukosh .	70,000.00	30,000.00	100,000.00
Komunë	Blerja e auto fshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotoareve,traktor me paisje përcjellëse për nevojat e Komunës	170,000.00	30,000.00	200,000.00
Komunë	Rregullimi dhe rikonstruimi i lumit "Toplluha" në Suharekë	100,000.00	50,000.00	150,000.00
Komunë	Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në Dubravë,Sallagrazhdë,Topliqan,Peqan dhe në Suhareke	65,000.00	35,000.00	100,000.00
Qytet SUHAREKE	Ndërtimi rrugëve lokale ne Suhareke	65,000.00	35,000.00	100,000.00
Qytet SUHAREKE	Ndërtimi dhe rikonstruimi i vorrezave ne Biraq	60,000.00	40,000.00	100,000.00
Sallagrazhdë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Daut Sokoli",	30,000.00	-	30,000.00
Samadraxhë	Ndërtimi rrugëve lokale "Jeton Kabashi",- segment,"5 Nëntori"-Segment,"Radika"- Segment,"Dardanët"-segment,"Avni Hodaj"- segment,"Feim Morina"-aneks në Samadraxhë .	50,000.00	30,000.00	80,000.00
Savrove	Ndërtimi i rrugës lokale "Dardha Binake"	20,000.00	-	20,000.00

Semetisht	Ndërtimi i rrugëve lokale "Mulla Ibrahim", "Ukë Bytyçi" degëzim dhe "Demush Rama" në Semetisht.	30,000.00	-	30,000.00
Sopijë	Ndërtimi i rrugëve lokale "Fadil Elshani"-segment "Reshit Sokoli"-segment, Nderi i Kombi"-segment, "Fadil Kabashi"-segment, në Sopijë.	40,000.00	10,000.00	50,000.00
Stravuqinë	Ndërtimi i rrugës lokale "Rruga Stavuqina Mohlan" vazhdim	10,000.00	-	10,000.00
Studençan	Ndërtimi i rrugëve lokale "Platoni", "Bilbilat", "Gurra e Fshatit", "Fëllënza", "Djerrinat", "Magjistarja Rahovec" 2 segmentet te Beqajt, "Dardania", "Lisat", "Arif Gashi", "dhe "Besnik Përzhaku" në Studençan.	80,000.00	-	80,000.00
Sllapuzhan	Ndërtimi i rrugës "Komandant Xhavitit"-segment "Zymer Basha", "Ruzhdi Elshani", në Sllapuzhan	20,000.00	-	20,000.00
Shirokë	Ndërtimi i impiantit te ujrave te zeza ne Dubrave	20,000.00	-	20,000.00
Tërrnje	Ndërtimi i rrugëve lokale "Martirë e Tërrnjës", ddegëzim	10,000.00		10,000.00
Tërrnje	Ndërtimi i rrugëve lokale "Martirë e Tërrnjës", ddegëzim	10,000.00		10,000.00
Vershec	Ndërtimi i rrugëve lokale "Dëshmorët e Vershecit", degëzim "Ushtari i Lirisë",	10,000.00	-	10,000.00
Vraniq	Ndërtimi i rrugëve lokale "Rruga e Staneve", "Ali Loshi", "Udha e Shkronjave"-segment, dhe "Muqajt".	40,000.00		40,000.00
Komunë	Ndërtimi i impiantit te ujrave te zeza ne Sllapuzhan	70,000.00	30,000.00	100,000.00

Njësia Profesionale Zjarrfikëse dhe Shpëtim NjPZSh në Suharekë si në çdo vitë, po ashtu dhe në këtë vitë do të vazhdojë në realizimin e detyrave për çka dhe është e dedikuar.

Detyra primare e këtij shërbimi është për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, si dhe të mirat materiale të tyre nga fatkeqësit natyrore, zjarret, ndeshjet në komunikacion si dhe në intervenime të ndryshme me kërkesen e qytetarëve..

Për tju përgjigjur kërkesave të qytetarëve në çdo kohë, kjo njësi është në gjendje gadishmerie 24 orë..

Sektori i NjPZSH do të mirëmbaj objektin si dhe tekniken të cilën e posedon sipas planit ditor të njësisë ku parashihet kontrollimi ditor, javor, dhe atë mujor.

NjPZSh në Therandë do të vazhdoj bashkpunimin me: NjPZSH të Regjionit, Shërbimin Policor në Therandë si dhe me insitucionet tjera.

Rregullisht do t'i raportojmë Drejtorit DSHPE-së , për gjendjen në njësi , si dhe për detyrat e realizuara.

Agjencionit të Menagjimit të Emërgjencave (AME-së) në Prishtinë i raportojmë një here në muaj për intervenimet e realizuara.

Në bashkpunim me sektorin e MC pranë Drejtorisë së DSHPE-së planifikojmë formimin e njësive vullnetare në kuadër të sektorit të NjPZSH, si dhe të sektorit për mbrojtje civile. Njëherit do të organizojmë ushtrim të përbashkët në nivel komunal me: NjPZSh, MC, PK, Kryqin e Kuq, si dhe me Emërgjencën.

NjPZSh planifikon që njëherë në muaj të ket takime zyrtare me shefat e udhëheqës të gupeve, kur se në çdo tre muaj me të gjithë puntorët e shërbimit zjarrëfikës dhe të shpëtim.

Pos detyrave të rendomta të cilat i ka ky shërbim, planifikojmë që ti mbajmë dhe disa ushtrime në nivel të ndërrimit, si dhe ate në nivel të njësisë.

Në nivel të ndërrimit do ti organizojmë në çdo tre muaj, kurse ate në nivel të njësis në çdo gjashtë muaj.

Ushtrimet në nivel të njësis do të tentojmë ti organizojmë në bashkpunim me NJPZSH të Regjionit.

Do të vazhdojmë me ngritjet e aftësimit profesional me kurse të ndyshme, të cilët organizohen në niveltë të AME-së

NjPZSh në Therandë gjatë viti 2026 planifikon që planin dhe programin e punës ta realizon me sukses sikurse dhe viteve të tjera.

PLAN PROGRAMI I PUNËS

NJPZSH në Therandë ka planifikuar orarin teorik dhe atë praktik të punës i cili është i ndarë në palin ditor, javor, dhe mujor.

PLANI DITOR I PUNËS

Sajë përket planit ditor kryerja e punëve fillon sipas rendit të ditës që me pranimin – dorëzimin e detyrës, kontrollimi ditor i paisjeve të njësisë.

PLANI JAVOR I PUNËS

Plani i kontrollimit javor përfshin : paisjet dhe aparatet për shuarjen e zjarrit, si dhe të automjeteve

PLANI VJETOR

JANAR

1. Analiza e punës e vitit të kaluar
2. Djegëja -Teori dhe Praktik
3. Produktet nga Djegëja
4. Shuarja e zjarreve
5. Njohuritë themeleore për shkaktarët e zjarreve dhe mbrojtja nga zjarre

SHKURT

1. Shkaktaret e zjarreve-teori
2. Mbrojtja nga zjarret në objekte ndërtimi-teori dhe praktik

MARS

1. Taktika e shuarjes së zjarreve- teori dhe praktik
2. Materiet të lëngëta që ndizen lehtë-teori
3. Çka është zjarri dhe klasifikimi i zjarreve -teori
4. Teori dhe praktikë për Aksidente Rrugore

PRILL

1. Shpëtimi i njerzëve ,shpëtimi i pasurisë, udhëheqja e aksionit gjatë intervenimit
2. Shuarja e zjarreve në teren të hapur
3. Shpëtimi i njerzëve me litar-teori
- 4 Shpëtimi i njerzëve me litar -praktik
5. Ushtrime me aparat të frymëmarrjes –praktik
6. Mënyra e shuarjes së zjarreve në ambientin e mbyllur dhe nxjerrja e viktimave .

MAJ

1. Shpëtimi i njerzëve nëpër objekte shkollore
2. Ushtrime me shkallë hidraulike
3. Ushtrime për aksidente rrugore
4. Ndihma e parë-teori
5. Ndihma e parë praktik

QERSHOR

1. Trajnimi me litar-shpëtimi i jetrave të njerzëve
2. Ushtrime me aparat të frymëmarrjes

KORRIK

1. Ngritja e nivelit të gadishmërisë, gjatë sezonit veror, zjarre fushore dhe malore

GUSHT

1. Gjendje gadishmërie për zjarre të ndryshme dhe për aksidente

SHTATOR

1. Teknika për zjarrfikje-paisje personale dhe mjetet të përbashkëta
2. Ushtrime me shkallë hidraulike

TETOR

1. Ushtrim në shkollë për shpëtimin e nxënësve dhe personelit të shkollës në raste të ndryshme si: zjarrit, termetit apo helmimeve, në bashkpunim me MC

NËNTOR

1. Ushtrime praktike në kushte të vështira klimatike
2. Shuarja e zjarreve me shkum
3. Shuarja e zjarreve me pluhur
4. Mirmbajtja e pompave të zjarrfiksave
5. Mirmbajtja e automjeteve për sezonin dimror dhe pregaditja

DHJETOR

1. Pregaditja për sezonin dimëror
2. Mirmbajtja e automjeteve për sezonin dimror
3. Vlersimet e puntorëve për punën e vitit 2026
4. Plani i punës për vitin 2027

PRIORITETET PËR VITIN 2026

1. Plotësim me staf (pranimin e zjarrfiksave të ri)
2. Kalimi në objektin e ri të NjPZSh në Shirokë

DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORT DHE MËRGATË

Objektivat zhvillimore në sektori e kulturës për vitin 2026

1. Ndërtimi i ri, përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës kulturore
 2. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore
 3. Formimi i institucioneve të reja kulturore
 4. Zhvillimi i kulturës dhe aktiviteteve kulturore në zonat rurale.
 5. Përkrahja financiare dhe bashkëpunimi me OJQ, SHKA dhe organizatat tjera kulturore.
 6. Aftësimi profesional kuadrove
 7. Bashkëpunimi kulturorë me diasporën dhe qytetet partnere jashtë vendit
 8. Formimi i komisioneve konsultative për fushat e ndryshme të kulturës
- Formimi i fondacionit për Kulturë.

PLANI I PUNËS 2026

Qëllimi	Veprimi/Aksioni	Afati kohor për përfundimin/	Kostoja financiare	Përgjegjësia (kush e bënë realizimin/ implementimin)
----------------	------------------------	-------------------------------------	---------------------------	---

(çka dëshirojmë të arrihet)	(cilat janë veprimet për t'i përmbushur objektivat)	përmbushjen e aktivitetit		
-----------------------------	---	---------------------------	--	--

Investimet Kapitale

Inventarizimi i shtëpisë së Kulturës	Paisja me Kompjuter, Printer Tavolina të punës Paisja e skenës me ndriqim dhe zërim profesional Paisja e dhomës së Baletit me pasqyre Paisja e dhomave përgatitore mbrapa skenës	Koha e implementimit: Janar-Dhjetor 2026	100,000 €	Operatori ekonomik që fiton tenderin	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat ,[OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
--------------------------------------	--	--	-----------	--------------------------------------	---	--

Manifestimet Festive dhe përkujtimore:

Zhvillimi i aktiviteteve rinore, kulturore sportive, humane , ekologjike dhe ruajtja e Traditës	Organizimi i Festarit 2025 Formimi i këshillit organizativ Formimi i grupeve punuese dhe përgatitjet teknike për realizimin e projektit.	Koha e implementimit : 22-27 Shtator	Bugjeti: 27.000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komunitet i i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat ,[OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtar e etj.
Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe bashkëpunim i me Diasporën	Organizimi i festës së diasporës “Diafest”	Koha e Implementimit Korrik - Gusht	7000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komunitet i i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtar e etj
Kremtimi i ditës së Pavarësisë	Realizimi i programit artistik për ditën e pavarësisë dhe aktiviteteve tjera	Koha e implementimit : 17 shkurt	Bugjeti: 5000 €	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komunitet i i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat

Kremtimi i ditës se Çlirimit	Realizimi i programit artistik për ditën e Çlirimit	Koha e implementimit : 13 Qershor	Bugjeti: 10.000 €	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Zhvillimi i turizmit Kulturor	Karnevali Red eagle	Koha e implementimit : Maj	Sponsorizim jo monetar infrastrukturë	Kompania Fruteks Komuna – DKRSM Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: Biznesi Privat Frutex
Kremtimi i ditës se flamurit Kombëtar	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë solemne 28 nëntori dita e flamurit:	Koha e implementimit : 27 Nëntor,	Bugjeti 2,000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Përkujtimi të viktimave të luftës:	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë përkujtimorë 26 marsi dita e përkujtimit të viktimave të luftës:	Koha e implementimit : 26 mars	Bugjeti 1500€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Përkujtimi – ndarja e Çmimit Ukë Bytyçi	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë përkujtimorë të Ukë Bytyçit:	Koha e implementimit : 27 tetor	Bugjeti 1500€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj.
Përkujtimi i kryetarit historik të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova	Organizimi i aktiviteteve artistike për Mbrëmjen artistike kushtuar veprimtarisë letrare dhe politike të presidenti Rugova	Koha e implementimit : 21 Janar	Bugjeti 1000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj.

Aktivitetet Kulturore:

Aktivitetet muzikore:

Organizimi i festivalit të solistëve nga komuna jonë:	Organizimi i festivalit, Formimi i Jurisë vlerësuese, Orkestrës Muzikore mbajtja e audicionit dhe programit artistik për finale, ndarja e çmimeve, skenografia ndriçimi etj.	Koha e implementimit : Maj Qershor	Bugjeti: 10,000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
Organizimi i festivalit të muzikor për fëmijë Theranda Fest Zbulimi talenteve të ri.	Organizimi i festivalit, Formimi i Jurisë vlerësuese, Orkestrimi e mbajtja e audicionit dhe programit artistik për finale, ndarja e çmimeve, skenografia ndriçimi etj.	Koha e implementimit : Maj Qershor	Bugjeti: 6000€	Komuna – DKRSM Dhe shoqëria civile OJQ Theranda Fest		Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
Aktivizimi , themelimi i grupeve muzikore në shkollë zhvillimi i aktiviteteve kulturore	Organizimi i festivalit të muzikës me grupet e shkollave fillore: Muzikë popullore, Klasike dhe zbavitëse. Valle popullore , klasike dhe valle moderne	Koha e implementimit : Prill	Bugjeti 5.000€	Komuna – DKRS, DKA, Shkollat fillore dhe shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
Ruajtja e trashëgimisë Muzikore	Botimi dhe inqizimi i CD me këngë të përpunuara Qytetare	Koha e implementimit Prill - Dhjetor	3500€	Grupet Muzikore	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.

Aktivitetet teatrale:

zhvillimi i aktiviteteve teatrale pasurimi i jetës kulturore ne Komune	përgatitje e 2 shfaqje teatrale: zgjedhja e tekstit, regjisorëve, aktoreve etj	Koha e implementimit: shkurt- maj Shtator-nëntor	Bugjeti 20,000€	Komuna – DKRSM Teatri i qytetit (Teatri i Ëndrrave)
zhvillimi i aktiviteteve teatrale angazhimi dhe zbulimi i talenteve te rrije pasurimi i jetesë kulturore ne shkolla .	Organizimi i festivalit te shfaqjeve teatrale „Fëmijët ne skenë“	Koha e implementimit: qershor	Bugjeti 5,000€	Komuna – DKRSM, DKA, Shkollat fillore dhe shoqëria civile
Komunikim Kulturor Themelimi i Çmimit për teatër Bekim Lumi	Organizimi i Festivalit me grupe teatrale nga rajoni 5 Shfaqje	Koha e implementimit: Maj	7000€	Koha e implementimit: Prill- maj

Aktivitetet ne artet pamore:

Zhvillimi i arteve pamore	Organizimi i dy ekspozitave kolektive	Janar dhjetor	Bugjet i 5,000 €	Komuna – DKRSM, dhe shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtar e etj
Zhvillimi i arteve pamore	Organizimi i 5 ekspozitave personale	Janar dhjetor	Bugjet i 5.000 €	Komuna – DKRSM, dhe shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtar e etj
Zhvillimi Artit dhe i punës kreative te të rritë	Art Interaktiv, Punëtori e artit në animacion dhe videoprojektim Tema ambijenti dhe natyra	Mars	5000€	Komuna – DKRSM, QEK Shtëpia e Fellbahut Artaction Group NY	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtar e etj
Dita e faleminderimit për SHBA 4 Korriku	Ekspozitë e Studentëve të fakultetit të artit nga Komuna e Suharekës.	Korrik	1500€	Komuna, Shoqëria Civile, Studentët		

Aktivitetet letrare :

Zhvillimi i arteve Letrare ne proze – poezi	Organizimi i konkursit Letrare.	Janar -Shkurt	Bugjeti 1,800€	Komuna – DKRS, dhe	Te mira, sipas dinamikës	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe
---	---------------------------------	---------------	----------------	--------------------	--------------------------	--

Themelimi i Çmimit për letersi “Ragip Sylaj”	Shpallja e konkursit, Vlerësimi i punimeve nga juria , shpallja e rezultateve dhe ndarja e çmimeve			shoqëria civile	se planifikuar	ndërkombëtare etj
Zhvillimi i te menduarit kreativ,bukur shkrimit , drejtshkrimit etj	Konkursi letrar për ese më të mira për të rinjë:	Koha e implementimit : Mars	Bugjeti. 1000€	Komuna – DKRS, DKA, Shkollat fillore dhe shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj
Prezantimi i krijueseve dhe vlerave letrare nga komuna e jone	Botimi i librit Brerore Lirie përgatitja teknike, botimi dhe promovimi.	Koha e implementimit : janar -nëntor	Bugjeti. 1750€	Komuna – DKRS, shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat ,
Bashkëpunimi letrar rajonal dhe mbar kombëtar	Organizimi i manifestimit Letrar Pranvera poetike Ndarja e Çmimit letrarë Ragip Sylaj	Koha e implementimit : Fillimi i majit	Bugjeti 1,500€	Komuna – DKRS, shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat ,
Ruajtja e veprimtarive kulturor Jubilare	Botimi i monografisë 20 vite Festari	Shkurt shtator	Bugjeti 10,000€	Grupi redaktues	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat ,
Përkrahja e shoqërive kulturore dhe individëve me mjete financiare	Për pjesëmarrje ne festivale , manifestime ,udhëtime , botime, pajisje etj .	Koha e implementimit : janar -nëntor	Bugjeti. Ndarje proporcionale nga planifikimi i aktiviteteve te cekura më lart	Komuna – DKRS, shoqëria civile	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj

Aktivitetet në Trashigiminë kulturore:

Aktivitetet teatrale:

Zhvillimi dhe ruajtja i Artizanateve të traditës	Festivali dhe punëtorja e Filigranit	Koha e implementimit: Prill - Shtator	Bugjeti 10,000€	Komuna – DKRSM Teatri i qytetit (Teatri i Ëndrrave)
Ruajtja e dhe databaza elektronike e eartefakteve arkeologjike	Krijimi Web Faqes Së Muzeut	Koha e implementimit: qershor	Bugjeti 3,000€	Komuna – DKRSM, DKA, Shkollat fillore dhe shoqëria civile
Digjitalizimi i trashëgimisë Kulturore	Dokumentimi Virtual Fotografimi dhe Gjirimi	Koha e implementimit: Prill - Nentor	10,000€	Koha e implementimit: Prill- maj
Kujdesi dhe ekspozimi i artefakteve dhe vlerave muzeale	Punimi i vitrinave ekspozuese	Koha e implementimit: Maj	15,000€	Koha e implementimit: Prill- maj

DREJTORIA PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MJEDIS

Janar

- Përmbyllja e raporteve vjetore nga zyrtaret me një përshkrim detal rreth zhvillimeve në drejtori për vitin 2025,
- Vlerësimi i stafit të drejtorisë për punën e bërë gjatë viti 2025,
- Hartimi i raportit rreth Legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje për vitin 2025,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit deri në përmbyllje të tyre,
- Punimi i raportit vjetor për vitin 2025,
- Shqyrtimi dhe mbyllja e lëndëve të vitit 2025,
- Kërkesë nga zyrtaret për efikasitetin në punë, për shërbime më të mira për qytetaret, respektim të orarit të punës dhe për punë më profesionale,
- Takim me ekipin punues rreth Zonës Industriale në Shirokë dhe Zonës Ekonomike në Duhël, prezantimi i skenarëve.

Shkurt

- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit deri në përmbyllje të tyre,
- Takim me ekipin punues rreth zbatimit të bonuseve të ndërtimit,
- Diskutim dhe dhënia e ideve rreth transparencës në Drejtori ndaj qytetareve dhe efikasitetit tonë në punë.
- Trajnimi i zyrtarëve për digjitalizimin e dokumenteve të DUPM-së, zbatimi i E-lejes.
- Formimi i grupit punues për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,

Mars

- Punimi i projekt propozimeve, detyrave projektuese si dhe i paramasave dhe parallogarive për iniciimet e procedurave të prokurimit,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit deri në përmbyllje të tyre,

- Takim me ekipin punues rreth Rregullores së Sheshit të Suharekës,
- Inicimi për shqyrtim publik për Zonës Industriale në Shirokë dhe Zonës Ekonomike në Duhël,
- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Përgatitja e Raportit Tremujor.

Prill

- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit deri ne përmbyllje te tyre,
- Formimi i grupit punues për planin rregullues të hollësishëm “Zona Qendër”,
- Formimi i grupit punues për planin rregullues të hollësishëm të Hisarit,
- Inicimi për shqyrtim publik për zbatimin e bonuseve të ndërtimit.

Maj

- Takim me ekipin punues rreth Zonës Industriale në Shirokë dhe Zonës Ekonomike në Duhël,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit,
- Diskutim dhe dhënia e ideve rreth transparencës në Drejtori ndaj qytetareve dhe efikasitetit tonë në punë,
- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Finalizimi i rregullores së Sheshit të Suharekës.

Qershor

- Menaxhimi i projekteve nën përgjegjësin e drejtorisë si dhe mbikëqyrja e tyre,
- Përgatitja e Raportit Gjashtëmujor,
- Rishqyrtimi i të arriturave gjashtëmujore, përparimet, ngecjet, sfidat dhe diskutimi i mundësive për një zhvillim sa më të qëndrueshëm të drejtorisë,
- Zotimet e mjeteve dhe iniciimet e Procedurave për Prokurim rreth projekteve kapitale,
- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.

Korrik

- Finalizimi për Zonës Industriale në Shirokë dhe Zonës Ekonomike në Duhël,
- Finalizimi për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Takim me ekipin punues rreth zbatimit të bonuseve të ndërtimit,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.

Gusht

- Finalizimi për Zonës Industriale në Shirokë dhe Zonës Ekonomike në Duhël,
- Finalizimi për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Takim me ekipin punues rreth zbatimit të bonuseve të ndërtimit,
- Trajtim me prioritet i lëndëve të legalizimit.

Shtator

- Përgatitja e Raportit Nëntëmujor,
- Shqyrtimi I kërkesave nga palët e interes për planin rregullues të hollësishëm të fshatit rekreativ – turistik në Delloc,
- Finalizimi i bonuseve të ndërtimit.

Tetor

- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm të Hisarit,
- Finalizimi i sistemit të Adresave në Territorin e Komunës përmes Memorandumit të bashkpunimit me Agjensionin Kadastral të Kosovës,
- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm “Zona Qendër”.

Nentor

- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm të Hisarit,
- Finalizimi i sistemit të Adresave në Territorin e Komunës përmes Memorandumit të bashkpunimit me Agjensionin Kadastral të Kosovës,
- Takim me ekipin punues për planin rregullues të hollësishëm “Zona Qendër”.

Dhjetor

- Përmbyllja e aktiviteteve nga komisionet e ndryshëm të formuara nga drejtoria apo kryetari e që kanë të bëjnë me punën në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit,
- Përgatitja e Raporteve finale për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij viti në drejtori si dhe për punën individuale të çdo zyrtari,
- Përgatitja e Raportit Vjetor 2026,
- Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i certifikatave për përdorim për projektet komunale të menaxhuara nga drejtorit tjerë si dhe nga drejtoria e urbanizmit sipas procedurave ligjore.

Inicimi i Procedurave të Projektëve në vitin 2025

PROJEKTET PËR FURNIZIM

	Përshkrimi i kontratës	Vlera e parashikimit të kontratës	Data e parashikimit e fillimit të prokurimit
1.	Furnizim me pajisje të teknologjisë për DUPM	5,000.00 €	02.05.2026
2.	Furnizimi me inventar	3,000.00 €	05.03.2026

PROJEKTET PËR SHËRBIME

Nr.	Përshkrimi i kontratës	Vlera e parashikimit të kontratës	Data e parashikimit e fillimit të prokurimit
1.	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	40,000.00 €	13.03.2026
2.	Hartimi dhe Revidimi i Projekteve	40,000.00 €	18.01.2026
3.	Trajtimi i Deponive Ilegale	20,000.00 €	10.04.2026
4.	Hartimi dhe Harmonizimi i Dokumenteve	100,000.00 €	15.03.2026
5.	Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave	30,000.00 €	20.03.2026
6.	Mbikqyrja e projekteve Investive	30,000.00 €	10.04.2026

7.	Trajtimi dhe planifikimi i hapësirave gjelbëruese konform PZHK-së	45,000.00 €	28.03.2026
8.	Trajtimi i ujrave industriale ne zonën industriale në Suharekë - finalizimi	25,000.00 €	03.04.2026
9.	Planifikimi dhe rregullimi i projektit pika e gjelbërt	5,000.00 €	27.02.2026
10.	Krijimi i hapësirave të gjelbruara në territorin e Komunës Suharekë	60,000.00 €	14.03.2026

PROJEKTET PËR PUNË

Nr.	Përshkrimi kontratës	Vlera e parashikimit të kontratës	Data e parashikimit e fillimit të prokurimit
1.	Ndërtimi i pullazeve dhe izolimi në objektet kolektive	60,000.00 €	25.02.2026
2	Ndërtimi i rrethojave urbane	150,000.00 €	01.03.2026
3.	Ndërtimi i zonave infrastrukturore të mençura SMART në Komunën e Suharekës	150,000.00 €	05.03.2026

Në planin e punës së përshkruar më lartë janë paraqitur vetëm aktivitetet kryesore që zhvillohen në drejtori.

Prioritet për vitin 2026 do të jetë:

- Përmbyllja e lëndëve të legalizimit,
- Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2029,
- Zbatimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrushëm Urban 2024-2034,
- Zbatimi i PZHK-së 2021-2029 dhe hartimi i raportit monitories,
- Zbatimi i HZK-së dhe hartimi i raportit monitorues.